



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova-Republic of Kosovo



**Komuna e Drenasit**

Zyra e Kryetarit

01- Nr 020/04 - 36685 dt. 03/09 2020

Në vështrim të nenit 13 dhe 58 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, në bazë të nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit dhe nenit 49 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kryetari i Komunës në Drenas, mori këtë :

## **V E N D I M**

**Për caktimin e komisionit për monitorim, raportim dhe vlerësim të  
Stratëgjisë së Zhvillimit Ekonomik Lokal 2020 - 2024 (Drenas)**

Anëtarët e Komisionit monitorim, raportim dhe vlerësim të Stratëgjisë së Zhvillimit Ekonomik Lokal 2020 – 2024:

1. Shehrije Mustafa- Kryetare e Komisionit,
2. Besim Tahiraj – Anëtar,
3. Besart Bajrami – Anëtar,
4. Adhurim Hoxha – Anëtar,
5. Shqipdon Zariqi – Anëtar,
6. Agim Kastrati – Anëtar,
7. Albulena Lushtaku-Hetemi - Antare.

- I. Komisioni punën do ta kryej sipas dispozitave të nenit 16 kapitullit V të udhëzimit administrativ (qrk) Nr. 07/2018 për planifikim dhe hartimin dokumenteve strategjike Stratëgjisë së Zhvillimit Ekonomik Lokal 2020 – 2024 të Komunës së Drenasit dhe akteve tjera ligjore lidhur me monitorim, raportim dhe vlerësimin e dokumenteve strategjike
- II. Komisioni ka për detyrë të bëjë monitorimin e rregullt të zbatimit të dokumenteve strategjike, duke përfshirë detaje rreth monitorimit, raportimit dhe rishikimit të ndërmjetëm, vlerësimit përfundimtar të zbatimit të dokumentit strategjik si dhe përmbushjen e prioriteteve strategjike komunale.

- III.** Komisioni do bëjë monitorim të vazhdueshëm të zbatimit të dokumentit të miratuar strategjik dhe të ndërmarrë veprime nëse është e nevojshme për të siguruar kryerjen në kohë dhe mënyrë efektive të aktiviteteve të përcaktuara në Planin e Veprimit
- IV.** Komisioni do të hartoj raport vjetor mbi progresin e zbatimit (raportin e progresit- Raporti i progresit duhet të ofrojë vlerësim të përgjithshëm të zbatimit dhe informata të detajuara lidhur me) të dokumentit strategjik që duhet të përgatitet deri në fund të tremujorit të parë të vitit pasues, dhe raport gjashtë mujor të monitorimit të planit të veprimit.
- V.** Komisioni për punën e vet i raporton Kryetarit të Komunës dhe Ministrisë së Linjës sipas kërkesës.
- VI.** Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e Kryetarit të Komunës.



**Kryetari i Komunës**

**Ramiza Lladrovci**

Iu dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Anëtarëve të Komisionit;
- DZHE- së;
- Arkivit të Komunës së Drenasit